



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**  
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË

# **EKONOMIA DHE BUXHETI**



**GUSHT, 2013**

# Raporti Mujor

Gusht, 2013

Kontakt:

Telefon: ++355 (4) 228 1009

e-mail: [elami@minfin.gov.al](mailto:elami@minfin.gov.al)

[www.minfin.gov.al](http://www.minfin.gov.al)

## PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE.....	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE.....	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL .....	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
ANEKSI STATISTIKOR .....	13


## VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin gusht 2013 arriti në 113.73 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin gusht ishte 1.2 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase* me dy monedhat kryesore të huaja për muajin gusht 2013 ishte 105.20 lekë për dollarë dhe 140.01 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit gusht shënuan kuotat 3.83 për ato 12-mujore, 3.07 për 6-mujoret dhe 2.35 për qind për depozitat 3-mujore dhe 2.72 për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 8.68 për qind për huatë 12-mujore dhe 9.38 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 1,149.3 miliardë lekë në muajin korrik, duke shënuar një rritje prej rreth 2.7 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave për 6-mujorin e parë të vitit 2013* rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej 62.8 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar - gusht 2013 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 57.8 miliardë lekë, ose 164.9 për qind e planit për periudhën;
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar - gusht 2013*, arritën në rreth 207.1 miliardë lekë, ose 91.3 për qind e planit për periudhën;
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë*, arritën në rreth 264.9 miliardë lekë, ose 101.1 për qind e shpenzimeve të planifikuara për periudhën.

## ZHVILLIMET EKONOMIKE

### 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin gusht 2013 pësoi një rënie prej 0.1 për qind krahasuar me muajin korrik '13, kur ky indeks shënonte një rënie prej 0.8 për qind, krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa gjatë muajit qershor '13, ky indeks ishte 0.6 për qind më i ulët se muaji maj '13. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti më



parë ishin 1.2 për qind, 1.6 për qind dhe 2.3 për qind. Rënia me e madhe mujore, gjatë muajit gusht u konstatua në grupin “Veshje dhe këpucë” me 3.76 për qind. Peshat specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bënë që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte të ulëta mbi normën e inflacionit (rreth 0.1 pikë përqindjeje).

Norma vjetore e inflacionit në muajin gusht arriti në 1.2 për qind, duke qëndruar jashtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2012 dhe 2013 paraqiten në tabelën 1.


**Tab - 1** Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
<b>2012</b>	1.6	0.6	1.0	1.6	1.9	2.2
<b>2013</b>	2.7	2.5	2.4	2.3	2.1	2.3
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2012</b>	2.7	2.8	2.6	2.4	2.5	2.4
<b>2013</b>	1.6	1.2				

Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin gusht 2013, arriti në 140.01 lekë/euro, duke shënuar një rënie me 0.21 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit gusht, një euro u këmbye me 139.98 lekë.



**Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit gusht'13**

Burimi: Banka e Shqipërisë


kundrejt dollarit amerikan në muajin gusht 2013, arriti në 105.20 lekë/dollarë duke shënuar një rënie prej 1.93 për qind kundrejt muajit korrik '13. Në fund të muajit gusht, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 105.71 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin gusht të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 5.0

për qind, ndërsa kundrejt monedhës europiane euro është nënçmuar me 1.94 për qind. Nënçmimi dhe mbiçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane euro dhe monedhës amerikane, në radhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rënie mesatare duke arritur në rreth 0.751 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitetet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë, etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit gusht 2013, normat e interesit të depozitave 12 mujore në lekë arritën kuotën e 3.83 për qind, duke shënuar një rënie me 0.43 pikë përqindje krahasuar me muajin




**Normat e interesit për depozitat (%)**

Burimi: Banka e Shqipërisë

korrik 2013. Rënie për këtë muaj ka pësuar edhe norma e interesit të depozitave me afat 1-mujor me 0.13 pikë përqindje, duke shkuar në 2.72 për qind. Rënie për këtë muaj janë vënë re gjithashtu në normat e interesit të depozitave me afate të maturimit 3, 6 dhe 24-mujore respektivisht me 0.21, 0.23 dhe 0.17 pikë përqindje, duke shkuar përkatësisht në 2.35, 3.83 dhe 5.66 për qind.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kanë pësuar rënie normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 1, 3, 6 dhe 12-mujore.



**Normat e interesit për huatë dhe bonot (%)**


Burimi: Banka e Shqipërisë

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit gusht pësoi një rënie me 1.56 pikë përqindje, duke arritur në 8.68 për qind nga 10.24 për qind që ishte në muajin korrik. Për këtë muaj, norma e interesit të huave 6-mujore pësoi një rënie me 1.98 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin gusht arriti në 9.38 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit gusht 2013, për bonot 12 dhe 6-mujore ishin përkatësisht 4.85 për qind dhe 4.52 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re një rënie në *yield*-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12-mujore dhe 6-mujore, me respektivisht 0.5 dhe 0.78 pikë përqindje.

## 4. Bilanci i Pagesave


Bilanci i pagesave për periudhën janar–qershor 2013 regjistroi një deficit të përgjithshëm prej 62.8 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në figurën 5, ku



**Bilanci i Pagesave 3-M II 2013**

Burimi: Banka e Shqipërisë

kontributin më të madh në të e jep zëri i “Llogaria kapitale dhe financiare” së bashku me nënzërat e saj, me 534.3 milionë euro, duke u rritur me 20.39% krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit 2012. “Llogaria korrente” për 6-mujorin e parë të vitit 2013-të rezultoi të jetë -519.4 milionë euro, ose gati 4.2% më e lartë se në 6-mujorin e parë të vitit 2012.




**Llogaria Korrente 3-M II 2013**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente prej 519.4 milionë euro, i shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për periudhën janar '13-qershor '13 rezultoi: (i) bilanci tregtar -730 mln euro, (ii) shërbime neto -81.1 mln euro, (iii) të ardhura neto -33.0 mln euro, (iv) transferta neto 324.8 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar


Gjatë muajit gusht 2013, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 25,795.4 milionë lekë krahasuar me gushtin e vitit 2012. Kjo rritje ka ardhur si



**Ecuria e M.V.N. të sistemit në gush'12 - gush'13**

Burimi: Banka e Shqipërisë

pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 6,655.4 milionë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 19,140.0 milionë lekë.



**Agregati M3 gush'12 - gush'13**


Burimi: Banka e Shqipërisë

Në muajin gusht '13 sistemi bankar rezulton me një rritje prej 17,065.1 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin korrik '13, rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 12,346.9 milionë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë, me rreth 4,718.2 milionë lekë.

## 6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin gusht 2013 arriti në 545.0 miliardë lekë. Rënia e tepricës së kredisë, krahasuar me fundvitin 2012 shënoi vlerën 9.77 miliardë lekë, me një rënie të lehtë prej rreth 1.76 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 60.8 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 331.1 miliardë lekë. Gjatë muajit gusht 2013, zëri “Korporata të tjera jofinanciare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 66.3 për qind ose 361.4 miliardë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin e 27.37 për qind ose 149.15 miliardë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.51 dhe 1.76 për qind apo 24.6 dhe 9.6 miliardë lekë.


Fig-9



**Rritja e stokut total të kredive**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-10



**Përberja e kredive gush '13**

Burimi: Banka e Shqipërisë


“Korporata të tjera jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.34 për qind dhe rreth 23.5 për qind.

qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 331.1 miliardë lekë. Gjatë muajit gusht 2013, zëri “Korporata të tjera jofinanciare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 66.3 për qind ose 361.4 miliardë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin e 27.37 për qind ose 149.15 miliardë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.51 dhe 1.76 për qind apo 24.6 dhe 9.6 miliardë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin gusht '13, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 55.43 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 33.4 për qind dhe nga “Korporata publike jofinanciare”, me 8.99 për qind. “Korporata të

## 7. Oferta e Parasë


Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin gusht ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës korrik 2013. Kjo ofertë arriti në rreth 1,149.3 miliardë lekë në fund të



**Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat**

Burimi: Banka e Shqipërisë

muajit gusht '13 duke shënuar një rritje prej 13.13 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin korrik '13. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 2.7 për qind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar. Ndërsa krahasuar me muajin paraardhës korrik '13, oferta e parasë pësoi një rritje të lehtë prej 1.2 për qind.




**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rritje prej 30.95 miliardë lekë në krahasim me muajin gusht 2012. Depozitat në valutë gjatë muajit gusht '13 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 87.3 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë sektori i individëve ka zënë rreth 89.13 për qind të tyre.


## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit gusht 2013, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 89.1 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 8.1 për qind dhe nga “Korporata publike jofinanciare”, me 1.3



për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 88.3 për qind dhe rreth 9.2 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 88.3 për qind e totalit (në lekë).

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 836.8 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 947,95 miliardë lekë në muajin gusht 2013. Ata



ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (87.1 miliardë), “Korporatat të tjera financiare” (11.5 miliardë) dhe “korporata jofinanciare publike” (11.2 miliardë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1.32 miliardë në totalin e depozitave. Gjatë muajit gusht 2013, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave pësoi një rritje me 13.05 miliardë lekë, kjo si rezultat i


rritjes së depozitave në lekë me rreth 12.08 miliardë lekë dhe i rritjes së depozitave në valutë me rreth 0.96 miliardë lekë.

## SEKTORI FISKAL

### 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar - gusht 2013 janë mbledhur rreth 207.1 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 264.9 miliardë lekë, që përfshijnë 217 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 47.9 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 56.4% janë financim i brendshëm dhe 43.6% financim i huaj.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 91.3% të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 101.1% të këtij plani. Shpenzimet korrente



#### Treguesit Fiskal, janar - gusht 2013

Burimi: Ministria e Financave

mbledhura nga pushteti vendor rreth 7.1 miliardë lekë (ose rreth 86% e planit të periudhës dhe 59.1% e planifikimit vjetor), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 39.8 miliardë lekë (ose rreth 99.4% e planit të periudhës dhe 65.3% e planifikimit vjetor), dhe të ardhurat jotatimore në nivelin 16.1 miliardë lekë (ose rreth 129.9% e planit të periudhës dhe 78.4% të planifikimit vjetor).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 217 miliardë lekë, 46.3 miliardë lekë (21.3% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 28.4 miliardë lekë (13.1%) për interesat, 22.3 miliardë lekë (10.3%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1 miliardë lekë (0.5%) për subvencione, 82.3 miliardë lekë (37.9%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 19.4 miliardë lekë (8.9%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 17.3 miliardë lekë (8%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 64.4% (shpenzime personeli), 55.7% (shpenzime për interesat), 67.7% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 63.5% (subvencione), 64.1% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 66.2% dhe 80.8% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 110.1% të shpenzimeve kapitale të parashikuara vjetore, ndërsa financimi i huaj është 45.8% e këtij planifikimi vjetor.

janë rreth 99.6% e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 110.9% të tij.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 141.5 miliardë lekë (ose rreth 87.5% e planit të periudhës dhe 55.4% e planifikimit të tij vjetor), të ardhurat e

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar - gusht 2013 ishin rreth 207.1 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 188.3 miliardë, të ardhurat jotatimore në rreth 16.1 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat e realizuara në janar-gusht 2013

Burimi	Miliardë lekë
TVSH	66.6
Tatimi mbi fitimin	10.3
Taksa doganore	3.6
Taksat nacionale	18.1
Akcizat	19.4

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe e Doganave.

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 57.8 miliardë lekë, për periudhën janar-gusht 2013, u mbështet në vlerën 46.5 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe rreth 11.3 miliardë nga burime të jashtme. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjete kryesor i financimit të brendshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin gusht 2013, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 25.136 miliardë lekë.
- Realizimi i shpenzimeve në masën 30.597 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për muajin gusht, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 24.2 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 27.6 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 3 miliardë lekë.

## Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2009	2010	2011	2012	2013	2009	2010	2011	2012	2013	2009	2010	2011	2012	2013	
Janar	0.4	0.9	0.8	0.7	1.0	0.40	1.00	0.80	0.71	1.00	2.1	3.6	3.3	1.6	2.7	January
Shkurt	0.7	1.1	2.3	1.3	1.1	0.55	1.02	1.55	1.01	1.05	1.9	4.7	4.5	0.6	2.5	February
Mars	0.6	0.1	-0.1	0.4	0.2	0.57	0.71	1.00	0.80	0.77	1.6	4.1	4.3	1.0	2.4	March
Prill	-0.1	-0.4	-0.6	-0.1	-0.1	0.40	0.42	0.60	0.58	0.55	1.9	3.7	4.1	1.6	2.3	April
Maj	-0.8	-1.2	-1.1	-0.8	-1.0	0.16	0.10	0.26	0.32	0.24	2.1	3.3	4.2	1.9	2.1	May
Qershor	-0.6	-0.7	-1.1	-0.8	-0.6	0.03	-0.04	0.04	0.12	0.16	2.3	3.2	3.9	2.2	2.3	June
Korrik	-0.7	-0.5	-0.7	-0.2	-0.8	-0.07	-0.10	-0.07	0.08	-0.03	2.2	3.4	3.6	2.7	1.6	July
<b>Gusht</b>	0.7	0.8	0.3	0.4	<b>-0.1</b>	0.03	0.01	-0.02	0.12	<b>-0.04</b>	2.2	3.5	3.1	2.8	<b>1.2</b>	<b>August</b>
Shtator	0.8	0.7	0.4	0.2		0.11	0.09	0.02	0.13		2.0	3.4	2.8	2.6		September
Tetor	0.4	0.2	0.4	0.2		0.14	0.10	0.06	0.14		2.3	3.0	3.0	2.4		October
Nëntor	0.4	0.2	0.1	0.2		0.16	0.11	0.06	0.14		2.8	2.8	2.9	2.5		November
Dhjetor	1.6	2.2	1.0	0.9		0.28	0.28	0.14	0.20		3.7	3.4	1.7	2.4		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

**Tab - 2** Kursi i këmbimit  
Exchange rate

Lekë për njësi të monedhës së huaj (Lek per unit of foreign currency)

Monedha	2009	2010	2011	2012	2013								Currency	
					Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug		
<i>Mesatarja e periudhës</i>														
USD	94.98	103.94	104.79	108.18	104.96	104.61	107.81	107.86	108.56	106.89	107.27	<b>105.20</b>	Average of period	USD
EURO	132.06	137.79	139.62	139.04	139.49	139.75	139.78	140.28	140.89	140.96	140.31	<b>140.01</b>		EURO
<i>Fundi i periudhës</i>														
USD	95.81	104.00	104.74	105.85	103.00	106.48	109.15	107.65	108.16	107.99	105.58	<b>105.71</b>	In the end of period	USD
EURO	137.96	138.77	139.62	139.59	139.58	139.66	139.91	140.72	140.45	140.96	140.20	<b>139.98</b>		EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2009	2010	2011	2012	2013								In percent
					Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	
<b>Norma e depozitave</b>													<b>Deposits rates</b>
12-M	6.78	6.07	6.07	5.17	5.07	5.25	5.36	5.04	5.11	4.59	4.26	<b>3.83</b>	12-M
6-M	5.74	5.16	5.16	4.30	4.20	4.25	4.32	4.15	4.09	3.64	3.30	<b>3.07</b>	6-M
3-M	5.05	4.42	4.42	3.78	3.56	3.71	3.66	3.42	3.23	2.78	2.56	<b>2.35</b>	3-M
1-M	4.56	4.70	4.70	3.06	2.75	3.09	2.89	2.87	3.19	3.01	2.85	<b>2.72</b>	1-M
<b>Norma e huasë</b>													<b>Lending rates</b>
12-M	12.46	11.52	11.52	10.58	9.26	11.57	11.11	10.58	10.12	10.90	10.24	<b>8.68</b>	12-M
6-M	12.54	11.69	11.69	10.34	9.80	11.13	9.67	8.85	11.60	9.56	11.36	<b>9.38</b>	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>													<b>Securities rates</b>
Bono thesari 1/													Treasury bills 1/
3-M	6.30	5.29	5.29	5.03	5.08	5.05	5.04	-	4.80	4.63	-	<b>3.85</b>	3-M
6-M	7.52	6.41	6.41	5.65	6.08	6.00	5.99	5.94	5.80	5.51	5.30	<b>4.52</b>	6-M
12-M	9.14	7.09	7.09	6.37	6.56	6.38	6.18	6.11	5.87	5.55	5.35	<b>4.85</b>	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**Tab - 4** TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2013  
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2013

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

Nr.	E M E R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>27,684</b>	<b>49,963</b>	<b>75,931</b>	<b>106,762</b>	<b>132,893</b>	<b>153,858</b>	<b>181,944</b>	<b>207,080</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>710</b>	<b>1,026</b>	<b>1,424</b>	<b>1,676</b>	<b>1,704</b>	<b>2,405</b>	<b>2,535</b>	<b>2,593</b>	<b>Grants</b>
II.	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>23,827</b>	<b>44,189</b>	<b>68,619</b>	<b>94,582</b>	<b>118,194</b>	<b>137,011</b>	<b>164,100</b>	<b>188,349</b>	<b>Tax Revenue</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>17,047</b>	<b>32,406</b>	<b>51,508</b>	<b>69,540</b>	<b>88,133</b>	<b>102,074</b>	<b>122,587</b>	<b>141,482</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	7,893	15,563	23,906	33,233	42,728	47,227	57,231	66,653	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,348	2,357	5,376	6,451	7,577	8,470	9,445	10,279	Profit Tax
3	Akcizat	2,540	4,668	7,022	9,844	12,981	16,658	20,072	23,464	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	2,705	4,937	7,334	9,665	11,987	14,078	17,105	19,430	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	2,216	4,137	6,713	8,742	10,745	13,105	15,641	18,065	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	345	744	1,157	1,605	2,115	2,536	3,093	3,591	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>862</b>	<b>1,356</b>	<b>2,241</b>	<b>4,522</b>	<b>5,047</b>	<b>5,438</b>	<b>6,429</b>	<b>7,095</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtësat)	206	331	600	1,223	1,346	1,451	1,629	1,804	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	314	360	507	1,052	1,082	1,097	1,426	1,466	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	342	665	1,134	2,247	2,619	2,888	3,374	3,825	Local Taxes
II.3	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>5,918</b>	<b>10,407</b>	<b>14,870</b>	<b>20,520</b>	<b>25,014</b>	<b>29,501</b>	<b>35,084</b>	<b>39,772</b>	<b>Social ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	5,529	9,380	13,646	16,954	20,734	24,593	29,857	33,599	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndëtsor	215	703	779	2,941	3,444	3,924	4,096	4,875	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	174	324	445	625	836	984	1,131	1,298	Revenues for property compensation
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>3,147</b>	<b>4,768</b>	<b>5,888</b>	<b>10,524</b>	<b>12,994</b>	<b>14,242</b>	<b>15,309</b>	<b>16,138</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	700	860	1,010	3,623	3,773	3,923	4,023	4,163	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,634	2,556	3,129	4,299	5,384	6,211	6,886	7,260	Income of budgetary institutions
3	Dividenti	0	2	5	5	905	905	922	927	Divident
4	Tarifat shërbimeve	427	677	848	1,294	1,518	1,653	1,814	2,070	Tariffs on services
5	Të tjera	386	673	896	1,303	1,414	1,550	1,664	1,718	Other/not allocated
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>27,884</b>	<b>59,414</b>	<b>90,558</b>	<b>130,149</b>	<b>171,181</b>	<b>205,237</b>	<b>234,314</b>	<b>264,911</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>23,976</b>	<b>50,078</b>	<b>76,198</b>	<b>103,608</b>	<b>134,471</b>	<b>163,816</b>	<b>189,430</b>	<b>216,997</b>	<b>Current Expenditures</b>
I.1	<b>Personell</b>	<b>5,835</b>	<b>11,358</b>	<b>17,121</b>	<b>22,895</b>	<b>28,669</b>	<b>34,525</b>	<b>40,457</b>	<b>46,325</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	4,861	9,792	14,764	19,739	24,753	29,799	34,930	40,021	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	774	1,566	2,357	3,156	3,916	4,726	5,527	6,304	Social insurance contributions
I.2	<b>Interesat</b>	<b>3,755</b>	<b>7,911</b>	<b>10,353</b>	<b>12,694</b>	<b>17,448</b>	<b>21,129</b>	<b>24,119</b>	<b>28,416</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	3,467	7,302	9,513	11,292	15,740	19,002	21,706	25,615	Domestic
2	Të Huaja	288	609	840	1,402	1,708	2,127	2,413	2,801	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>1,139</b>	<b>3,553</b>	<b>6,488</b>	<b>9,664</b>	<b>13,487</b>	<b>17,399</b>	<b>19,580</b>	<b>22,262</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
I.4	<b>Subveclonet</b>	<b>60</b>	<b>223</b>	<b>294</b>	<b>377</b>	<b>479</b>	<b>733</b>	<b>810</b>	<b>1,016</b>	<b>Subsidies</b>
I.6	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>8,753</b>	<b>18,935</b>	<b>28,913</b>	<b>39,413</b>	<b>49,699</b>	<b>60,558</b>	<b>71,144</b>	<b>82,323</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	7,000	14,208	21,746	29,522	37,327	45,514	53,617	62,368	Social insurance
2	Sigurime Shëndëtsore	1,753	4,352	6,792	9,366	11,847	14,341	16,823	19,251	Health insurance
I.7	<b>Shpenzime për Buxhetin Vendor</b>	<b>1,282</b>	<b>3,440</b>	<b>6,271</b>	<b>8,969</b>	<b>12,437</b>	<b>15,326</b>	<b>17,488</b>	<b>19,362</b>	<b>Local budget expenditure</b>
I.8	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>3,352</b>	<b>4,658</b>	<b>6,758</b>	<b>9,596</b>	<b>12,282</b>	<b>14,206</b>	<b>15,832</b>	<b>17,293</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	75	143	216	284	350	416	475	545	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	3,277	4,215	6,178	7,866	9,563	11,258	12,507	13,858	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përndjekurve politike	300	300	364	1,446	2,339	2,532	2,850	2,890	Compensation for ex-political prisoners
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>3,908</b>	<b>9,336</b>	<b>14,360</b>	<b>26,541</b>	<b>33,237</b>	<b>41,421</b>	<b>44,884</b>	<b>47,914</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	1,289	4,540	6,866	16,945	20,356	23,249	24,952	27,041	Domestically financed
2	Financimi Huaj	2,619	4,796	7,494	9,596	12,881	18,172	19,932	20,873	Foreign financed
	<b>DEFICITI</b>	<b>-200</b>	<b>-9,451</b>	<b>-14,627</b>	<b>-23,367</b>	<b>-38,289</b>	<b>-51,579</b>	<b>-52,370</b>	<b>-57,831</b>	<b>CASH BALANCE</b>
	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>200</b>	<b>9,451</b>	<b>14,627</b>	<b>23,367</b>	<b>38,289</b>	<b>51,579</b>	<b>52,370</b>	<b>57,831</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
	<b>Brendshëm</b>	<b>-1,123</b>	<b>6,794</b>	<b>9,863</b>	<b>19,238</b>	<b>31,761</b>	<b>41,619</b>	<b>41,266</b>	<b>46,479</b>	<b>Domestic</b>
	Të ardhura nga privatizimi	90	106	193	212	15,733	15,845	15,896	15,960	Privatization receipts
	Hua-marje e brendshme	3,822	9,734	18,984	22,802	22,965	25,256	24,738	23,488	Domestic new borrowing (net)
	Nacionale	3,793	9,684	18,932	22,732	22,887	25,163	24,653	23,405	Other
	Lokale	29	50	52	70	78	93	85	83	Foreign
	Të tjera	-5,035	-3,046	-9,314	-3,776	-6,937	-518	632	7,031	Other
	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	-4,650	-2,244	-7,526	-2,754	-7,202	-885	-6,569	69	Government deposits into the Central Bank
	Të tjera	-385	-803	-1,787	-1,021	265	1,402	7,201	6,962	Other
	Depozita e ISSH dhe ISKSH	-798	-1,894	-459	-1,663	-2,046	-1,273	21	-70	Deposits of Social and Health insurance
	Mjete në ruajtje	-119	-97	-30	-51	-111	-38	75	203	Preservation stock
	Nënhua	89	89	143	365	388	420	569	569	On-Loan Principal
	Detyrim ndaj ISSH	703	17	2,422	818	-23	410	1,707	1,744	Liabilities to SSI
	Të tjera (detyrime të përkohshme)	-260	1,082	-3,863	-490	2,057	1,882	4,829	4,516	Other-Float
	<b>I huaj</b>	<b>1,323</b>	<b>2,657</b>	<b>4,764</b>	<b>4,129</b>	<b>6,528</b>	<b>9,961</b>	<b>11,104</b>	<b>11,352</b>	<b>Foreign</b>
	Hua afatgjatë(e marrë)	2,420	4,321	5,879	7,543	12,670	16,597	17,804	18,651	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nënhua	21	50	61	61	61	61	155	155	
	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-509	-508	284	407	-548	-690	-267	-239	Change of stat. Account
	Ripagesat	-588	-1,156	-1,399	-3,821	-4,695	-5,946	-6,433	-7,060	Repayments

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

\* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

"Change of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit

Tab - 5

## Tabela e investimeve 2013

Table of investments 2013

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht Aug	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>1,289</b>	<b>4,540</b>	<b>6,866</b>	<b>16,945</b>	<b>20,356</b>	<b>23,249</b>	<b>24,952</b>	<b>27,041</b>	<b>Domestic financing</b>
<i>Në %</i>	32.98	48.63	47.81	63.84	61.24	56.13	55.59	56.44	<i>In %</i>
<b>Financim i huaj</b>	<b>2,619</b>	<b>4,796</b>	<b>7,494</b>	<b>9,596</b>	<b>12,881</b>	<b>18,172</b>	<b>19,932</b>	<b>20,873</b>	<b>Foreign financing</b>
<i>Në %</i>	67.02	51.37	52.19	36.16	38.76	43.87	44.41	43.56	<i>In %</i>
<b>Totali</b>	<b>3,908</b>	<b>9,336</b>	<b>14,360</b>	<b>26,541</b>	<b>33,237</b>	<b>41,421</b>	<b>44,884</b>	<b>47,914</b>	<b>Total</b>
<i>Në %</i>	100	100	100	100	100	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2013 (CUSTOMS REVENUES 2013)

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht Agust	
Taksë doganore	345	744	1,157	1,605	2,115	2,536	3,093	3,591	Customs Duties
TVSH	5,776	11,862	18,225	25,683	33,250	39,226	47,440	55,228	V.A.T
Akcizë	2,327	4,422	6,791	9,618	12,723	16,400	19,814	23,206	Excises
Të tjera	684	1,158	2,013	2,586	3,335	4,203	4,723	5,592	Others
<b>TOTALI</b>	<b>9,132</b>	<b>18,186</b>	<b>28,186</b>	<b>39,492</b>	<b>51,423</b>	<b>62,365</b>	<b>75,070</b>	<b>87,617</b>	<b>Total</b>

## TË ARDHURAT TATIMORE 2013 (TAX REVENUE )

TVSH	2,117	3,701	5,681	7,550	9,478	8,001	9,791	11,425	V.A.T
Akciza	213	246	231	225	258	258	259	258	Excises
Tatim mbi fitimin	1,348	2,357	5,376	6,451	7,577	8,470	9,445	10,279	Profit Tax
